

4PLUS - Ndërgjegjësimi Publik, Gatishmëria, Pjesëmarrja dhe Koordinimi për një Mbrojtje Civile Gjithëpërfshirëse

Konteksti

Dokumenti i BE-së "Përshatja ndaj ndryshimeve klimatike në Evropë" thekson rritjen e rrezikut të dëmtimit të njerëzve, infrastrukturës dhe mjedisit për shkak të ndryshimit të klimës, dhe tërheqin vëmendjen për nevojën për veprim paraprak dhe reagim në politika e shteteve anëtare. Gjithashtu, të ngritura edhe në "Programin Ndërkufitar IPA II Interreg Shqipëri - Greqi 2014-2020", fatkeqësitë natyrore apo të shkaktuara nga njeriu paraqesin sfida të ndjeshme ndaj zhvillimit të qëndrueshëm, kryesisht në zonën ndërkufitare.

Në veçanti zjarret dhe përmbytjet, gjithnjë e më tepër kanë ndikime ndërkufitare duke e bërë të domosdoshme qasjen e përbashkët ndaj këtyre fenomeneve. Por, pavarësisht se ndërhyrja ndaj këtyre rasteve po merr më tepër vëmendje në të dy shtetet, ende mungojnë udhëzimet strategjike për të asistuar PAK dhe moshën e tretë, duke i ekspozuar ata ndaj rreziqeve të ndryshme.

Objektivat e projektit

Objektivi kryesor i projektit është të zhvillojë një qasje gjithëpërfshirëse për mbrojtje civile efektive dhe reduktim të rrezikut të fatkeqësive natyrore në nivel ndërkufitar.

OS1. Advokimi, përgjatë zonës CB, rritje e kapaciteteve në reduktimin e rrezikut dhe rritja e gatishmërisë në menaxhimin e emergjencave civile, me fokus PAK/grup-mosha e tretë;

OS2. Asistence teknike për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e autoriteteve vendore dhe grupeve të interesit për të reaguar ndaj fatkeqësive të shkaktuara nga natyra/njeriu, me fokus PAK/ grup-mosha e tretë;

OS3. Përmirësimi i komunikimit, bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet sektorëve/aktorëve të interesit

drejt arritjes së rezultateve gjithëpërfshirëse për parandalimin/reduktimin e rrezikut;

OS4. Zhvillimi i bazave të të dhënave, standardeve, platformave trajnuese, aplikacione TIK, për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm për parandalimin efektiv të rrezikut me fokus PAK dhe grup-moshën e tretë;

OS5. Përcaktimi i mekanizmave për monitorim të vazhdueshëm të progresit në rritjen e gatishmërisë në menaxhimin e emergjencave civile me fokus PAK dhe grup-moshën e tretë.



Rezultatet e Projektit

- Shkëmbimi i njohurive dhe praktikave të mira midis partnerëve CB;
- Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve vendore në zonën e CB;
- Ndërgjegjësimi i komuniteteve vendore mbi rëndësinë ekonomike si dhe rëndësinë sociale të mbështetjes së personave me lëvizshmëri të reduktuar në përgjithësi;
- Krijimi i vlerës së shtuar për burimet vendore;
- Akses dhe të besueshmëri gjatë realizimit të aksioneve të shpëtimit;
- Bashkëpunim me median dhe organizatat për PAK;
- Përgatitja ndaj fatkeqësive, edukimi dhe trajnimi;
- Hartimi dhe zbatimi i strategjive;
- Rritja e ndjenjës së sigurisë në nivel komuniteti dhe individ.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATOR:

- Komisioni i Bashkimit Evropian

PËRFITUES:

- Konfederata Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara, (NCDP)
- Unioni Rajonal i Komunave të Ishujve të Jonit, (PED Ionion Nison) Unioni Rajonal i Komunave të Maqedoninë Perëndimore (PED W. Macedonia)
- Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
- Bashkia e Kolonjës
- Instituti i Kërkimeve Urbane

KOHËZGJATJA:

- 01/06/2018 - 31/05/2020

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane
Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.